



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-04

**Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës**

**Vendosi:** Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 14 korrik 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për Paraqitjen e Listave të Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale (F00583)**

---

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të  
Specializuar**  
Aleks Uajting

**Mbrojtjes së të Akuzuarit**  
Zhan-Lui Zhilisen

**Mbrojtësit të Viktimave**  
Sajmon Loz

**TRUPI GJYKUES I** (Trupi Gjykues) nxjerr këtë vendim mbi kërkesën e Mbrojtjes për zgjatjen e afatit për paraqitjen e listave të dëshmitarëve dhe të provave materiale (F00583).

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 qershor 2023, Trupi Gjykues caktoi datat për paraqitjen e provave nga ana e Mbrojtjes, në rast se ajo vendos të paraqesë prova, dhe urdhëroi Mbrojtjen që ndër të tjera të dorëzojë listat e dëshmitarëve dhe të provave materiale brenda 17 korrikut 2023. Gjithashtu, Trupi Gjykues caktoi datën 18 shtator 2023 për fillimin e paraqitjes së provave të Mbrojtjes.<sup>1</sup>

2. Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) e përfundoi paraqitjen e provave të saj më 6 korrik 2023.<sup>2</sup> Po atë ditë, Mbrojtja njoftoi Trupin Gjykues për synimin për të kërkuar hedhjen poshtë të disa akuzave në Aktakuzën e Konfirmuar<sup>3</sup> dhe për të paraqitur provat e saj.<sup>4</sup>

3. Më 12 korrik 2023, Mbrojtja kërkoi zgjatje të afatit për paraqitjen e listave të dëshmitarëve dhe provave materiale deri më 18 gusht 2023 (Kërkesa).<sup>5</sup> Mbrojtja parashtron se “thjesht nuk është në gjendje ta respektojë afatin aktual”, sepse do të kryejë hetime gjatë pushimit të verës dhe duhet të takohet me dëshmitarët e

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 16 qershor 2023, publik, f. 2017, rreshti 12 deri f. 2025, rreshti 10.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-04, F00570, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë për Mbylljen e Paraqitjes së Provave në përputhje me Rregullën 129*, 6 korrik 2023, publik.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-04, F00098/A01, Prokurori i Specializuar, *Aktakuza e Korrigjuar*, 1 nëntor 2021. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 16 nëntor 2021, [F00107/A01](#).

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-04, F00571, Mbrojtja, *Njoftim i Mbrojtjes në bazë të Rregullave 119(1) dhe 130 të Rregullores dhe Kërkesë për Zgjatje Afati dhe Shtim të Numrit të Lejuar të Fjalëve*, 6 korrik 2023, publik, para. 1, 4.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-04, F00583, Mbrojtja, *Kërkesë e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Listës së Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale të Saj sipas Rregullës 119(2)(a) dhe (b) të Rregullores*, 12 korrik 2023, publike, para. 1, 14.

propozuar për të konfirmuar aftësinë dhe gatishmërinë e tyre për të dëshmuar. Mbrojtja shton se është gjithashtu duke punuar me disa afate njëkohësisht dhe se i duhet të përgatitet për seancat e planifikuara për periudhën pas pushimeve të verës dhe për paraqitjen e provave të saj.<sup>6</sup>

4. Më 14 korrik 2023, ZPS-ja iu përgjigj Kërkesës duke parashtruar se (i) ajo e kundërshton Kërkesën për zgjatje të kohës për listat e dëshmitarëve dhe të provave materiale, por (ii) nuk kundërshton zgjatjen deri fill pas përfundimit të pushimit veror të gjykatës të afatit për nxjerrjen e informacionit/shqyrtimin e deklaratave të dëshmitarëve dhe provave materiale që Mbrojtja do të përfshijë në listat e saj.<sup>7</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Trupi Gjykses merr parasysh nenet 40(2) dhe (6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, dhe rregullat 9(5)(a), 23(2)(a), (6), dhe 76 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

## III. DISKUTIM

6. Trupi Gjykses konstaton se Kërkesa është paraqitur në kohë të mjaftueshme për t'i mundësuar Trupit Gjykses të marrë vendim në lidhje me të përpara përfundimit të afatit në fjalë, në përputhje me rregullën 76 të Rregullores.

---

<sup>6</sup> Kërkesa, para. 6-12.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-04, F00590, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Listave të Saj të Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale* (Përgjigjja), 14 korrik 2023, publike, para. 1-2, 8-9.

7. Sa i përket zgjatjes së afatit të kërkuar, Trupi Gjykses vëren se: (i) i akuzuari u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës<sup>8</sup> dhe bëri paraqitjen e parë në prill 2021,<sup>9</sup> më se dy vjet më parë;<sup>10</sup> (ii) qysh në hapje të procesit, më 21 shkurt 2023, Trupi Gjykses parashikoi se ZPS-ja do ta kishte përfunduar paraqitjen e provave përpara pushimit veror të gjykatës;<sup>11</sup> (iii) gjatë paraqitjes të provave nga ZPS-ja, Trupi Gjykses nuk mbajti seanca gjyqësore gjithë kohën, sepse sallën e gjyqit është dashur ta përdorin edhe trupa të tjerë gjykses;<sup>12</sup> dhe (iv) Mbrojtja ka kërkuar dhe i janë dhënë disa zgjatje afatesh për të përballuar respektimin e afateve të tjera të njëkohshme.<sup>13</sup> Në përputhje me këtë, Trupi Gjykses mendon se deri tani Mbrojtja duhet të kishte përparuar mjaftueshëm në hetimet e veta dhe se duhet të ishte e përgatitur të respektonte afatet e vëna nga Trupi Gjykses dhe të dorëzonte listat e dëshmitarëve dhe të provave materiale pas përfundimit të paraqitjes së provave nga ZPS-ja.

8. Megjithatë, dhe pavarësisht kundërshtimeve të ZPS-së,<sup>14</sup> Trupi Gjykses e ka parasysh parashtrimin e Mbrojtjes se ajo është ende duke kryer hetime dhe pret të

---

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-04, F00019/RED, Administratorja, *Version i Redaktuar Publik i 'Njoftimit për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit', parashtrimi i protokolluar F00019, datë 15 prill 2021, 15 prill 2021 (data e versionit të redaktuar publik 26 prill 2021), publik.*

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 19 prill 2021, publik.

<sup>10</sup> *Shih edhe parashtrimet më të fundit të Mbrojtjes mbi kohëzgjatjen e mbajtjes në paraburgim të të akzuarit, KSC-BC-2020-04, F00588, Mbrojtja, Parashtrime të Mbrojtjes në lidhje me Rishikimin e Dymbëdhjetë të Paraburgimit të Pjetër Shalës, 13 korrik 2023, publik, para. 8.*

<sup>11</sup> KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 21 shkurt 2023, publik, f. 567, rreshtat 5-10.

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-04, F00434/RED, Trupi Gjykses I, [Public redacted version of Decision on the conduct of the proceedings](#), (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Zhvillimin e Gjykimit) 24 shkurt 2023, publik, para. 20.

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-04, F00580, Trupi Gjykses I, [Decision on the Defence request for an extension of time and word limit for its motion under Rule 130 of the Rules F00586](#), (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Zgjatje Afati dhe Shtim të Numrit të Lejuar të Fjalëve për Mocionin e Saj në bazë të Rregullës 130 të Rregullores F00586) 11 korrik 2023, publik, para. 12 (a), (b); F00586, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Zgjatje Afati (F00582)*, 13 korrik 2023, publik, para. 16 (b), (c).

<sup>14</sup> Përgjigjja, para. 1, 6-9.

takohet me dëshmitarët gjatë pushimit veror të gjykatës.<sup>15</sup> Për këtë arsye, Trupi Gjykses vendos ta ndryshojë afatin në përputhje me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, duke pasur parasysh edhe të drejtat e pjesëmarrësve të tjerë dhe ecurinë e shpejtë të procesit.

9. Rrjedhimisht, Mbrojtja urdhërohet që deri të **mërkurën, 16 gusht 2023, në orën 12:00:**

- a. të paraqesë listat e saj dëshmitarëve dhe të provave materiale që përmbajnë informacionin e përcaktuar në rregullën 119(2)(a) dhe (b) të Rregullores;
- b. të lejojë ZPS-në dhe Mbrojtësin e Viktimave të shqyrtojnë dhe të kopjojnë të gjitha deklaratat, dokumentet, fotografitë apo sendet e tjera të prekshme që janë në zotërim dhe kontroll të Mbrojtjes dhe që synohen të përdoren nga Mbrojtja si prova në gjykim;
- c. t'i japë ZPS-së dhe Mbrojtësit të Viktimave deklaratat, në se ka, të të gjithë dëshmitarëve që Mbrojtja synon të thërrasë në gjykim dhe të gjitha deklaratat e marra që Mbrojtja synon t'i paraqesë në gjykim; dhe
- d. t'i japë ZPS-së dhe Mbrojtësit të Viktimave provat materiale që Mbrojtja synon të paraqesë në gjykim, siç përcaktohen në rregullën 104(5), (6) dhe (7) të rregullores.

10. Në lidhje me këtë Mbrojtja duhet t'i respektojë udhëzimet e mëparshme të Trupit Gjykses që përfshihen në këtë vendim përmes referencave.<sup>16</sup>

---

<sup>15</sup> Kërkesa, para. 8.

<sup>16</sup> KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 16 qershor 2023, publik, f. 2019, rreshti 25 deri f. 2020, rreshti 10; F00434/RED, Trupi Gjykses I, [Public redacted version of Decision on the conduct of the proceedings](#), (Version i Redaktuar Publik i Vendimit Mbi Zhvillimin e Gjyimit) 24 shkurt 2023, publik, para. 27-28, 30-33, 35, 56, 64, 68-69.

11. Datat e vendosura për konferencën përgatitore të Mbrojtjes dhe për fillimin e paraqitjes së provave të Mbrojtjes do të mbeten të pandryshuara.<sup>17</sup>
12. Trupi Gjykses gjykon se Mbrojtësit të Viktimave nuk i shkaktohet asnjë dëm nga marrja e vendimit mbi Kërkesën pa i dhënë atij mundësi të dëgjohet.
13. Së fundi, Trupi Gjykses udhëzon Mbrojtjen që në të ardhmen, kur kërkon zgjatje për disa afate paralele, të bëjë kërkesa përmbledhëse për të kërkuar zgjatje kohe. Kjo do t'i japë Trupit Gjykses mundësi ta vlerësojë kërkesën në përgjithësi dhe t'i lejojë, jo vetëm Trupit Gjykses, por edhe të gjithë palëve dhe pjesëmarrësve që të përdorin kohën dhe burimet në mënyrën më të frytshme, duke përmirësuar kështu efikasitetin e gjithë procesit gjyqësor.

#### IV. VENDIM

14. Për arsyet e mësipërme, Trupi Gjykses:
  - a. **MIRATON**, pjesërisht, Kërkesën;
  - b. **URDHËRON** Mbrojtjen të paraqesë listat e dëshmitarëve dhe të provave materiale jo më vonë se **të mërkurën, 16 gusht 2023, në 12:00;** dhe
  - c. **URDHËRON** Mbrojtjen të respektojë detyrimet për nxjerrjen e informacionit dhe udhëzimeve të Trupit Gjykses, siç përcaktohen në paragrafët 9 dhe 10 të këtij vendimi.

---

<sup>17</sup> E njëjta gjë vlen edhe për datat e caktuara për paraqitjen e provave nga Mbrojtësi i Viktimave, të cilat mbeten të pandryshuara; KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 16 qershor 2023, publik, f. 2020, rreshtat 11-18; f. 2021, rreshtat 9-16; Transkripti i seancës, 26 qershor 2023, publik, f. 2028, rreshtat 3-7.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatëse Mapi Feld-Folia**  
**Kryegjykatëse**

/nënshkrimi/

---

**Gjykatës Zhilber Biti**

/nënshkrimi/

---

**Gjykatës Roland Dekers**

E premte, 14 korrik 2023

Në Hagë, Holandë.